



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 139/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi Kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Besianë, paraqitur kundër Besnik Tahiri kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Besianë, për shkak të vendosjes të banerit mbi rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Besianë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Besianë, në të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 11:53 kanë vërejtur se mbi rrugën “Zahir Pajaziti” në Besianë ishte vendosur baneri i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Besnik Tahiri me numër 20 nga radhët e AAK-së. Andaj me këtë veprim është bërë shkelje e nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, pretendohet në ankesën e LVV-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë një fotografi dhe emrin e një dëshmitarit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i me datë 05.06.2014 e informoi subjektin politik AAK, për ankesën që është kundër këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesën për Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 06.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik AAK, me të cilën theksohet se vendosja e banerit mund të jetë bërë nga individ te pa identifikuar, dhe konfirmon se si është njoftuar për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti, menjëherë ka kontaktuar Shtabin Zgjedhor në Besianë për ta larguar banerin, dhe si provë kanë bashkangjitur fotografi në të cilën shihet që nuk ekziston baneri në atë vend. Si dhe Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së për respektimin e Rregullave dhe Ligjin për Zgjedhjet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik AAK, ka vendosur banerin mbi rrugën publike “Zahir Pajaziti” në Besianë, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik AAK, pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik AAK ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se “*Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore*“ duke pasur parasysh se nga ana e subjektit politik AAK është larguar baneri në fjalë, menjëherë pas marrjes së Kërkesës për Përgjigje dhe Urdhër për Ndërmarr Masat Përmirësuese nga PZAP-i, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në Kërkesën për Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 139/2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

